



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELONA L. SALIAJ
ADRESA Blv. "Bajram Curri", pallatet
"1 Maj", shkalla nr. 9, kati parë
TEL: 692816131



KONTRATË SHITJE PASURIE LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 304

Nr. koleksioni: 62

Tirane më 29/04/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022051780007244315



A2022051780007244315

KONTRATË SHITJE ME REZERVË KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË "KOSHERJA" SH.P.K)

Sot, më datë 29 Prill 2022 (dymijë e njëzet e dy), ditë e Premte, para meje Notere **Elona L. Saliaj**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë Noterie në Tiranë, Blv. "B. Curri", P. "1 Maji", shk. 9, k.1, u paraqitën personalisht:

PALA SHITËSE ME REZERVË:

1. Z. Dorjan KOÇILLARI, atësia Stavro, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë Rr. "Ibrahim Rugova"; Nd. 2; H. 26; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; Tiranë, i datëlindjes 18.03.1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me letërnjoftim ID nr. 034313079 dhe nr. personal H60318060Q. (në cilësinë e shitësit të kuotës së Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës").

2. Znj. Elvina KOÇLLARI, atësia Ramazan, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë, Rr. "Ibrahim Rugova"; Nd. 2; H. 26; Ap. 13; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; Tiranë, e datëlindjes 13.02.1987, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me letërnjoftim ID nr. 034313182 dhe nr. personal I75213071P. (në cilësinë e bashkëshortes së shitësit të kuotës të Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., Dorjan KOÇILLARI, këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës").

3. Z. Elton KOÇI, atësia Kiço, me shtetësi Shqiptare, lindur në Fier, banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Kongresi I Lushnjës"; Nd. 82; H. 6; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, e datëlindjes 03.07.1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034206063 dhe nr. personal H70703056S. (në cilësinë e shitësit të kuotës së Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës").

4. Znj. Dorina BOÇI, atësia Stavri, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Kongresi I Lushnjës"; Nd. 82; H. 6; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, e datëlindjes 11.09.1980, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034139884 dhe nr. personal I05911044W. (në cilësinë e bashkëshortes së shitësit të kuotës të Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., Elton KOÇI, këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës").

5. Z. Jonis ISAJ, atësia Shpëtim, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banuese në Tiranë, me adresë Rr. "Artan Lenja"; Nd. 57; H. 5; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, i datëlindjes 03.03.1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034512601 dhe nr. personal I40303125W. (në cilësinë e shitësit të kuotës së Shoqërisë "Kosherja" Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si "Shitës").

6. Znj. Blenda LENA, atësia Frederik, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë Rr. "Artan Lenja"; Nd. 57; H. 5; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, e datëlindjes 08.02.1990, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftim ID nr.

Fq. 1



A2022051780007244315

034077424 dhe nr. personal J05208068K. (në cilësinë e bashkëshortes së shitësit të kuotës të Shoqërisë “Kosherja” Sh.p.k., Jonis ISAJ, këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si “Shitës”).

dhe

PALA BLERËSE ME REZERVË:

1.Z. Gjergji SOLLAKU, atësia Nikolla, me shtetësi Shqiptare, lindur në Kukës, banues në Tiranë, me adresë Rr. “Sandër Prosi”; Nd. 10; H. 1; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, i datëlindjes 30.03.1965, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033866429 dhe nr. personal G50330174E.

2. Z. Manfred ISAK, atësia Niko, me shtetësi Shqiptare, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë Rr. “Robert Shvarc”; Nd. 73; H. 5; Ap. 5; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, i datëlindjes 21.06.1967, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 034171385 dhe nr. personal G70621036V. (në cilësinë e Blerësve të kuotës së kapitalit të Shoqërisë “Kosherja” Sh.p.k., këtu e më poshtë për efektet e kësaj kontrate, cilësuar si **Blerës**.)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705, 746, 747, 748 e vijues i tij, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, si dhe ligjit nr. 110/2018 “Për notërinë”, i ndryshuar, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Shitjes me rezervë të kuotës së kapitalit të Shoqërisë “**KOSHERJA**” Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

1.1 Shoqëria “**KOSHERJA**” sh.p.k, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar si person juridik në QKB (Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) me numër Unik Identifikimi të subjektit L81523033M, e themeluar më datë 20/03/2018 dhe e regjistruar më datë 23/03/2018, me seli në Tiranë, Rr. “Jul Variboba”, numër 18. Shoqëria përbëhet nga Ortakët:

- **Z. Dorjan KOÇILLARI**, ortak i shoqërisë “**Kosherja**” Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 33,33 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 3.333,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Z. Elton KOÇI**, ortak i shoqërisë “**Kosherja**” Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 33,34 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 3.334,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë;

- **Z. Jonis ISAJ**, ortak i shoqërisë “**Kosherja**” Sh.p.k, i cili është pronar i një kuote, **numri i pjesëve: 1,00**, zotërues i 33,33 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 3.333,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie: “Aktivitet Bar-Kafe-Restorant; shërbime në fusha të ndryshme etj.....”



A2022051780007244315

1.2 Objekt i kësaj kontrate është *Shitja me rezervë* nga ana e *Shitësve* e një kuote, që i përket 100% të kapitalit themeltar, që i korrespondon 10.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë "**KOSHERJA**" *Sh.p.k., kundrejt Blerësve me rezervë*, në këtë mënyrë:

- Blerësit **Gjergji SOLLAKU**, i kalon në pronësi një kuotë, numri i pjesëve: 1,00, që i përket 50% të kapitalit themeltar;
- Blerësit **Manfred ISAK**, i kalon në pronësi një kuotë, numri i pjesëve: 1,00, që i përket 50% të kapitalit themeltar;

1.3 *Blerësve së bashku u kalon në pronësi një* kuotë, që i përket 100 % të kapitalit themeltar, që i korrespondon 10.000,00 pjesë të zotëruara të Shoqërisë "**KOSHERJA**" *Sh.p.k.*

1.3 Shitja me rezervë e kuotës së kapitalit themeltar të kësaj shoqërie nga ana e *shitësve* në masën 100 % gjithsej dhe *Blerja me rezervë* nga ana e secilit *Blerës sipas pjesëve më lart e një* kuote kapitali, që i përket gjithsej 100% të kapitalit themeltar, si më sipër, sjell humbjen e të drejtës së pronësisë së *Shitësve* mbi këtë kuotë dhe transferimin me të drejta të plota tek secili *Blerës, vetëm pas likuidimit total të vlerës monetare*, e cila do të realizohet deri më datë 06 Maj 2022, me transfertë bankare, ku ortakët blerësi **Gjergji SOLLAKU** do të bëhet pronar i një kuote, në masën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, që i korrespondon vlerës 5.000,00 lekë, pjesë të zotëruara të Shoqërisë dhe blerësi **Manfred ISAK** do të bëhet pronar i një kuote në masën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, që i korrespondon vlerës 5.000,00 lekë, si pasojë e këtij trasanksioni shitje.

1.4 Në këtë mënyrë, me kalimin e pronësisë me anë të kësaj *Kontrate Shitje me rezervë* të kuotës së kapitalit të Shoqërisë "**Kosherja**" *Sh.p.k*, gjendja e pronësisë së kuotës do të ndryshojë në këtë mënyrë:

- Shitësit **Elton KOÇI** së bashku me bashkëshorten e tij **Dorina BOÇI**, **Dorjan KOÇILLARI** së bashku me bashkëshorten e tij **Elvina KOÇILLARI**, dhe **Jonis ISAJ**, së bashku me bashkëshorten e tij **Blenda LENA**, humbasin tërësisht pronësinë e një kuote, që i përket 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "**KOSHERJA**" *Sh.p.k.*, vetëm pas likuidimit total të vlerës monetare të përcaktuar për shitjen e saj, e vërtetuar me mandat bankar.
- Blerësi **Z. Gjergji SOLLAKU**, bëhet pronar dhe zotërues i një kuote kapitali, të përbërë nga 50 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 5.000,00 lekë, pjesë të zotëruara të Shoqërisë;
- Blerësi **Z. Manfred ISAK**, bëhet pronar dhe zotërues i një kuote kapitali, të përbërë nga 50 % e kapitalit themeltar, që i korrespondon vlerës 5.000,00 lekë, pjesë të zotëruara të Shoqërisë.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES ME REZERVË DHE MËNYRA E LIKUIDIMIT

2.1 Çmimi i shitjes me rezervë i kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësit i detyrohet Shitësve për blerjen e kuotës që i përket 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "**KOSHERJA**" *Sh.p.k.*, është në vlerë monetare në monedhën Euro gjithsej **9'000 Euro (nëntë mijë)**. Çmimi total në shumën prej EURO 9'000, është i barasvlershëm me çmimin total në Lekë në shumën prej 1'089'900 (1 euro -121.10 lekë), i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë për njësi të monedhës së huaj Euro, përditësimi i fundit datë 29 Prill 2022, ora 12.25, bashkëlidhur kësaj kontrate.

2.2 Pala blerëse merr përsipër detyrimin që vlera monetare e sipërcituar të likuidohet **brenda datës 06 Maj 2022** me transfertë bankare, në pjesë të barabarta, nga secili blerës kundrejt secilit shitës.



A2022051780007244315

Vlera monetare e sipërcituar do të likuidohet me transfertë bankare brenda datës 06 Maj 2022, në këtë mënyrë:

- Vlera monetare prej 3'000 Euro (*tre mijë*), do të likuidohet nga Blerësit në pjesë të barabarta, me transfertë bankare në Bankën "American Bank of Investments" sh.a., me nga 1'500 Euro (një mijë e pesëqind) secili, në llogarinë bankare të shitësit **Dorjan KOÇLLARI**, me nr. IBAN numër AL23 2101 1029 0000 0000 0272 0331, SWIFT EMPOALTR. Bashkëshortja e **Dorjan KOÇLLARI, znj. Elvina KOÇLLARI**, është dakord që vlera monetare për shitjen e kuotës së kapitalit të kalojë në llogarinë personale të bashkëshortit të saj.
- Vlera monetare prej 3'000 Euro (*tre mijë*), do të likuidohet nga Blerësit në pjesë të barabarta, me transfertë bankare në Bankën "Raiffeisen BANK" sh.a., me nga 1'500 Euro (një mijë e pesëqind) secili, në llogarinë bankare në Lekë (e cila do të konvertohet) të shitësit **Elton KOÇI**, me nr. llogarie 000 138 1208, IBAN numër AL31 2021 1037 0000 0000 0138 1208. Bashkëshortja e **Elton KOÇI, znj. Dorina BOÇI**, është dakord që vlera monetare për shitjen e kuotës së kapitalit të kalojë në llogarinë personale të bashkëshortit të saj.
- Vlera monetare prej 3'000 Euro (*tre mijë*), do të likuidohet nga Blerësit në pjesë të barabarta, me transfertë bankare në Bankën "Raiffeisen Bank" sh.a., me nga 1'500 Euro (një mijë e pesëqind) secili, në llogarinë bankare të shitësit **Jonis ISAJ**, me nr. IBAN numër AL07 2021 1082 0000 0000 1101 0562. Bashkëshortja e **Jonis ISAJ, znj. Blenda LENA**, është dakord që vlera monetare për shitjen e kuotës së kapitalit të kalojë në llogarinë personale të bashkëshortit të saj.

2.3 Me vërtetimin shlyerjes totale të vlerës monetare të shitjes së kuotës së kapitalit brenda datës 06 Maj 2022 nga pala blerëse kundrejt palës shitëse, kjo e fundit zhvishet tërësisht nga pronësia e kuotës së shoqërisë dhe palës Blerëse i kalon në pronësi pasuria e luajtshme, kuota përkatëse e kapitalit të shoqërisë me të drejta të plota, e lirë nga çdo peng dhe detyrim tjetër.

2.4 Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë lloj pretendimi as tani as në të ardhmen për vlerën e përcaktuar për shitjen e kuotës

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705, 746, 747, 748 dhe vijues të tij;
- 3.2 Kodi Shqiptar i Familjes (neni 73, 74/a e vijues i tij).
- 3.3 Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", me ndryshimet.
- 3.4 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet;
- 3.5 Ligji nr. 110/2018 "Për Noterinë"; me ndryshimet.

NENI 4

KALIMI I PRONËSISË ME REZERVË

4.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë Shitje me rezervë prodhon efektet juridike të parashikuara nga Neni 705, 706, 747 e vijues i Kodit Civil. Në këto kushte, me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala blerëse ka detyrimin të shlyejë vlerën monetare të përcaktuar në këtë kontratë brenda datës 06 Maj 2022. Pas vërtetimit të shlyerjes së detyrimit monetare, pala blerëse ka të drejtë të regjistrojë kontratën në QKB për kalimin e pronësisë, ku pronësia me të drejta të plota e kuotës së shoqërisë, kalon tek blerësit dhe pasqyrohen ndryshimet përkatëse, vetëm në momentin e likuidimit të plotë të vlerës monetare përkatëse. Me likuidimin e vlerës monetare totale për blerjen e kuotës së shoqërisë, pronësia kalon nga shitësit tek blerësit me të drejta të plota, e lirë nga çdo peng apo detyrim tjetër real dhe pa asnjë kusht. Nëse Pala Blerëse është e gatshme për të likuiduar vlerën monetare totale më



A2022051780007244315

shpejt se sa afati i përcaktuar për shlyerjen e saj të plotë, atëherë regjistrimi i ndryshimeve të pronësisë bëhet menjëherë me paraqitjen e mandat pagesës nga pala blerëse.

4.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësit mbeten pronarë të pasurisë së luajtshme, deri në shlyerjen e vlerës monetare nga pala blerëse. Në rast shlyerje të vlerës monetare nga pala blerëse, e vërtetuar me mandat pagesat bankare, pala shitëse e humbet pronësinë e tij mbi kuotën e kapitalit zotërues që shet, duke mos pasur në të ardhmen asnjë pretendim apo përgjegjësi pronësie mbi këtë kuotë në shoqërinë "Kosherja" sh.p.k. ndërsa Blerësit bëhen pronarë të ligjshëm të kuotës sipas specifikimit të kësaj kontrate mbi këtë kuotë, duke e zotëruar atë tërësisht.

4.3 Termat e kësaj kontrate Shitje me rezervë, nuk do të ndryshojnë për sa kohë do të zgjasë marrëdhënia e detyrimit.

4.4 Menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje me rezervë, pala Blerëse ka detyrimin që brenda datës 06 Maj 2022 të likujdohë vlerën monetare, më pas ka të drejtë të depozitohë kontratën në QKB, e cila do të kalojë në pronësi të Blerësve, me të drejta të plota.

4.5 Në rast se pala blerëse nuk likuidon vlerën monetare totale të shitjes së kësaj pasurie, kjo kontratë mbetet pa efekte juridike dhe palët kthehen në gjendjen e mëparshme. Në rast se pala blerëse ka hedhur një pjesë të vlerës monetare në llogari të shitësve, këta të fundit janë të detyruar të kthejnë vlerën monetare përkatëse në llogari të blerësve.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

5.1 Për zbatimin dhe realizimin e kësaj kontrate shitje me rezervë kuote kapitali të shoqërie, palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:

A. Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit me rezervë:

- *Shitësi* merr përsipër dhe deklaron se kuota e shoqërisë objekt i kësaj kontrate shitje me rezervë, është në pronësinë e tij dhe se këtë kuotë ua shet me rezervë *Blerësve*, me çmimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.
- *Shitësi* me nënshkrimin e kësaj kontrate, shpreh vullnetin që depozitimi i kontratës së shitjes së kuotës të regjistrohet në QKB, vetëm pas shlyerjes totale të vlerës së saj dhe më pas të bëhet regjistrimi dhe kalimi i pronësisë në favor të blerësve me të drejta të plota dhe pa asnjë kusht.
- *Shitësit* garantojnë *Blerësit* se kuota e pasurisë që shesin është në pronësi të tyre, fakt ky i cili vërtetohet nga ekstrakti historik i shoqërisë. Gjithashtu, *Shitësit* garantojnë *Blerësit* se kuota nuk është e rënduar me barrë dhe nuk është lënë peng, apo të drejta të tjera reale në favor të personave të tretë dhe të cilat mund të përbëjnë shkak për mbështetjen e pretendimeve të të tretëve mbi pronësinë e kësaj kuote, të cilat mund të sjellin si pasojë cenimin e të drejtës së pronësisë së *Blerësve*.

B. Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit me rezervë:

- *Blerësit*, me nënshkrimin e kësaj kontrate, u kalon pronësia me rezervë, por ndryshimi i pronësisë së saj në QKB do të bëhet vetëm pas shlyerjes së vlerës monetare totale në favor të shitësve, brenda datës 06 Maj 2022.
- *Blerësit* deklarojnë se marrin përsipër detyrimin që të likujdojnë në favor të shitësve, nëpërmjet bankës, vlerën totale të çmimit të shitjes së kuotës së kapitalit të përcaktuar në këtë kontratë, nëpërmjet bankës në numrin e llogarisë së shitësve, brenda datës 06 Maj 2022.
- Në rast se pala Blerëse, nuk ka mundësi financiare për likuidimin e të gjithë vlerës monetare të përcaktuar në këtë kontratë ose nuk e likuidon atë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë,



A2022051780007244315

atëherë kjo kontratë nuk prodhon më efekte juridike dhe palët kthehen në gjendjen e mëparshme.

C. Të drejta dhe detyrime dypalëshe:

- Palët kontraktuese deklarojnë se kanë detyrimin për të kryer regjistrimin e kësaj kontrate në QKB, vetëm pas shlyerjes së detyrimit për blerjen e kësaj pasurie.

- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, prona vijon të mbetet në pronësi të shitësve deri në likuidimin e plotë të vlerës monetare, dhe regjistrohet në QKB, pasi të bëhet shlyerja e detyrimit.

5.1 Palët mbeten të lidhura me njëra tjetrën deri në momentin e shlyerjes totale të vlerës monetare të përcaktuar në këtë kontratë.

5.2 Pas likuidimit total të vlerës monetare kundrejt palës shitëse, ky i fundit zhvishet tërësisht nga pronësia e kuotës dhe pala Blerëse bëhen ortakë dhe pronarë të Shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k dhe kanë të drejtë të kërkojnë pasqyrimin e ndryshimeve dhe regjistrimin e kontratës në QKB (Qendrën Kombëtare të Biznesit), për të bërë ndryshimet përkatëse.

5.3 Nga informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Sigurorese, në rezultatet e kërkimit sipas shkresës bashkëngjitur kësaj kontrate; rezulton se Shoqëria "KOSHERJA" sh.p.k, si dhe ortakët e saj **Dorjan KOÇILLARI, Jonis ISAJ dhe Elton KOÇI është e lirë nga çdo barrë e peng mbi kotën e kapitalit.**

5.4 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, blerësit kanë detyrimin të shlyejnë detyrimin kontraktor brenda datës -06 Maj 2022, të vërtetuar me mandat bankar dhe pas kësaj Shitësit humbasin çdo të drejtë pronësie si dhe çdo të drejtë tjetër për sa i përket pjesës së kuotës takuese të kapitalit të shoqërisë që ua shet Blerësve, duke u kaluar atyre çdo të drejtë dhe përgjegjësi mbi kuotën e shoqërisë.

5.5 Blerësit, si Ortakë të Shoqërisë, kanë të drejtën dhe detyrimin ligjor të respektojnë dispozitat përkatëse për njohjen e shoqërisë, duke marrë përsipër dhe duke njohur çdo të drejtë dhe detyrim të shoqërisë kundrejt të tretëve, si aktivin ashtu edhe pasivin e saj.

NENI 6

HEQJA DORË NGA TË DREJTAT

6.1 Shitësit deklarojnë nën përgjegjësinë e tyre personale se pasi të bëhet shlyerja totale e vlerës monetare të kësaj kontrate, ata heqin dorë tërësisht nga të drejtat që i kanë takuar përgjatë periudhës së zotërimit të objektit të shitjes në shoqëri, apo çdo të drejtë tjetër pa kufizim ku përfshihen të drejta pune, dividendi, asetet, etj.

NENI 7

REGJISTRIMI I AKTIT NOTERIAL NË QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE

7.1 Palët deklarojnë se morën dijeni për kryerjen e regjistrimit të këtij akti noterial pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) Tiranë, për të bërë njoftimin përkatës dhe njohjen e kontratës, vetëm pas shlyerjes totale të vlerës monetare për blerjen e kuotës, vërtetuar me mandat bankar. Kjo kontratë pas kësaj do të të depozitohet në QKB, ku do të bëhen ndryshimet përkatëse dhe kalimi i pronësisë sipas kontratës në bazë të Ligjit Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 8

INTERPRETIMI I KONTRATËS NË TËRËSI

8.1 Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



A2022051780007244315

8.2 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.

NENI 9
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI,
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

9.1 Kjo kontratë, është hartuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe konkretisht me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 705, 746, 747, 748 e vijues i tij e vijues të tij si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet.

9.2 Për sa i përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e tjera të Kodit Civil dhe në Legjislacionin përkatës.

9.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhen me marrëveshje dhe mirëkuptim të ndërsjellët midis tyre, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

9.4 Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, secila prej tyre mund t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 10
ANEKSET E KONTRATËS

10.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 4, datë 29 Prill 2022;
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “KOSHERJA” sh.p.k, aksesuar online nga e-Albania nga unë Noterja, sot më datë 29 Prill 2022;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, datë 29 Prill 2022, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 11
SHPENZIMET E KONTRATËS

11.1 Shpenzimet për përpilimin dhe hartimin e Kontratës së Shitjes me rezervë, shpenzimet noteriale dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, janë në ngarkim të të dyja palëve.

NENI 12
GJUHA E HARTIMIT TË KONTRATËS

12.1 Kontrata u hartua në gjuhën shqipe prej meje Noteres në 5 (pesë) kopje, me vlera të njëjta juridike; mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të palëve kontraktuese. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, një kopje depozitohet në QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve) për t’u regjistruar transaksioni i kryer pasi të bëhet likuidimi i plotë i vlerës monetare dhe kopjet e tjerë u vihen në dispozicion respektivisht palëve kontraktuese.

NENI 13
HYRJA NË FUQI

13.1 Kjo Kontratë Shitje kuote e kapitalit hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit të palëve në Prani të Noteres, nënshkrimit të saj nga unë Noterja dhe regjistrimit të Kontratës me nr. Repertori dhe Koleksioni në regjistrin Noterial.



A2022051780007244315

NENI 14

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

14.1 Kontrata e Shitjes me rezervë e kuotës së kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

14.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar, nënshkrimin e tyre.

14.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", i ndryshuar, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

Dorjan KOÇILLARI

(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)

Dorjan Koçillari

Elvina KOÇILLARI

(në cilësinë e bashkëshortes së Shitësit Dorjan KOÇILLARI)

Elvina Koçillari

Elton KOÇI

(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)

ELTON KOÇI

Dorina BOÇI

(në cilësinë e bashkëshortes së Shitësit Elton KOÇI)

Dorina Boçi

Jonis ISAJ

(në cilësinë e ortakut të shoqërisë "KOSHERJA" sh.p.k)

Jonis Isaj

Blenda LENA

(në cilësinë e bashkëshortes së Shitësit Jonis ISAJ)

Blenda Lena

PALA BLERËSE

Gjergji SOLLAKU

Gjergji Sollaku

Manfred ISAK

MANFRED ISAK

Manfred Isak

KOSHERJA SHPK

NIPT L8-1523033M

NOTERE

Elona L. SALIAJ




Elona L. Saliaj

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20220429121541682
Data e Rezultatit te Kerkimit: 29.04.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 12:15:41PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-314-846
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

DORJAN STAVRO KOCILLARI
ELTON KICO KOCI
JONIS SHPETIM ISAJ



Florida Dervishi

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20220429122048986
Data e Rezultatit të Kërkimit: 29.04.2022
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:20:49PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-314-846
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

KOSHERJA SH.P.K.



Florida Dersh

ËKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81523033M
2. Data e Regjistrimit	23/03/2018
3. Emri i Subjektit	KOSHERJA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	20/03/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 20/03/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Jul Variboba", nr.18
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00
9. Objekti i aktivitetit	A) Aktivitet Bar-Kafe-Restorant; Sherbime ne fusha te ndryshme si: Organizinii i ekspozitave, konferencave, eventeve te biznesit dhe kulturore, sportive, argetuese, organizim i panairove/eventeve gastronomike, agrobiznes dhe pijeve; Qendra trajnimi profesionale per aktivitetet e rendesishme te shoqerise ne fushat e kulinariise, bar-restorant hotelerise, azileve, shtepise se femijes dhe gjithçka qe perfshin agrobiznesi. B) Importin dhe tregtimin e produkteve shtepiake dhe perdorim profesional me dy fokus te veçante ne sektoret e turizmit, hotele, spitale, shtepi banimi, qe perfshin shitjet ne bare, restorante, hotele, pastrime kimike dhe lavanderi, kafeteri, supermarket dhe qendra tregtare. C) Marrja ne menaxhim te parkingjeve, mensave, supermarketeve, qendrave tregtare, sportive, kampingjeve, hoteleve, moteleve, vendpushimeve, parqe argëtimi dhe objekteve turistike ne pergjithesi, plazhe dhe hapësira per



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>çlodhje, restorante, bar, edhe me argetime te peraferta, kafene, piceri, bare, restorante, duke perfshire vete-sherbimin, klube nate dhe salla vallezi kinema ne vende publike ne pergjithesi. Ç) Sherbimet e pastrimit, paketimin e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, ambalazhimin dhe etiketimin e ushqimeve dhe pijeve, trajtimin e ngarkesave dhe paketimeve edhe me ndihmen e transportit gjysme-mekanike, transport per llogari te te treteve, duhet te theksohet se keto aktivitete do te kryhen ne perputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi dhe i nenshtrohen lejeve te nevojshme dhe futjes ne regjistrat dhe per ushtrimin e aktiviteteve apo transaksioneve te nevojshme ne vendin e punes, kompania duhet te mbeshtetet nga profesioniste te jashtem te regjistruar ne pergjegjesine e akredituar profesionale dhe/ose teknike, partneret dhe jo-anetaret qe kane kualifikimet e percaktuara si rezultat i pozicionit te sakte te shprehur nga kompania. Ne kuader te ketyre aktiviteteve shoqeria do te jete ne gjendje te marre apo te jape, perfaqesime, garancite dhe agjenci grant, te importit dhe eksportit te te mirave te lartpermendura, te hape dhe menaxhoje dyqane, pika shitjeje dhe koncesionare, si ne Shqiperi dhe jashte saj, te beje transport per llogari te vet dhe/ose palet e treta. Shoqeria mund te marre pjese ne konkurse, oferta, iniciativa private, procedurave te negociuara, ankande, tendere, kontrata, procedurat per financimin e projektit, te organizuara nga institucionet shteterore dhe publike nga kompani private apo kontraktuese te pergjithshme, organizata, biznese. D) Shoqeria gjithashtu mund te kete pjesemarrje dhe interesa ne shoqeri apo ndermarrje te tjera, te cilat kane dy objekt te ngjashem, te perafert ose te lidhur me objektin e shoqerise, te cilat konsiderohen te nevojshme ose te dobishme per permbushjen e objektit te shoqerise.</p>	
10. Administratori/ët	Elton Koçi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 01/07/2019	Deri: 01/07/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	DorjanKoçillari	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.1 Vlera e kapitalit	Para: 3.333,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,33	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	EltonKoçi	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 3.334,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,34	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Ortakët	JonisIsaj	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 3.333,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	33,33	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: KOSHERJA E-Mail: office@gaccounting.al Telefon: 0692052679	
17. Statusi:	Aktiv	

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Regjistrimi Fillestar: CN-710802-03-18

HISTORIKU I REGJISTRIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
18/02/2019	<p>Numri i ceshtjes: CN-104908-02-19</p> <p>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit të asamblesë së ortakëve, datë 17.09.2018, ku është vendosur: Miratimi i shitjes me rezerve së 25% të kuotave të shoqërisë . Depozitimi i kontratës së shitjes së kuotave me Rezerve Nr.1320 Rep., Nr.443/12 Kol., datë 28.09.2018, nëpërmjet së cilës janë transferuar 25% të kuotave nga pala shitëse: Z. Arvin Kita tek pala blerëse Z. Dorjan Koçillari, Z. Elton Koçi dhe Z. Jonis Isaj. Depozitimi i Shtojcë vendimit te asamblese se ortakeve date 18.01.2019. Depozitimi i mandateve per shlyerjen e çmimit te shitjes se 25% te kuotave te kapitalit te shoqerise.</p> <p><u>Numri i aksioneve</u> ishte "4,00" u be "3,00"</p> <p><u>Vlera e aksionit</u> ishte "2.500,00" u be "3.333,33"</p> <p><u>E-Mail</u> ishte ("") u be ("office@gaccounting.al")</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek ortakët individ:</u></p> <p>eshte larguar ortaku: ("Arvin Kita")</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ishte ("2.500,00") u be ("3.333,00") , Kontributi në para</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ishte ("25,00") u be ("33,33") , Përqindja në kapital</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ("2.500,00") u be ("3.333,00") , Kontributi në para ishte</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ("25,00") u be ("33,33") , Përqindja në kapital ishte</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ("2.500,00") u be ("3.334,00") , Kontributi në para ishte</p> <p>Kane ndryshuar te dhenat per ("25,00") u be ("33,34") , Përqindja në kapital ishte</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u></p> <p><u>Transferim i kuotave te kapitalit</u></p> <p><u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u></p> <p><u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u></p> <p><u>Dokumenti i autorizimit</u></p>
03/07/2019	<p>Numri i ceshtjes: CN-249556-07-19</p> <p>Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 01.07.2019, ku eshte vendosur, riemerimi i administratorit te shoqerise.</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANÇAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Kane ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek administratoret:

Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Elton Koçi")

Kohëzgjatja nga ishte ("20/03/2018") u be ("01/07/2019")

Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Elton Koçi")

Kohëzgjatja deri ishte ("20/03/2019") u be ("01/07/2024")

Lista e Dokumenteve:

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Vendim i asamblese se pergjithshme

Datë: 29/04/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/04/29 09:39:31 +02:00
L81523033M2022042909392088
3006

5

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

Udhëzim 66/2006 "Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të Lekut në Bankën e Shqipërisë"

Ti ke kërkuar

Periudha kohore: 29.04.2022 - 29.04.2022

Monedha e zgjedhur: Euro (EUR)

1 - 1 nga 1 rezultate
Faqe 1 nga 1

Data	Lekë për njësi të monedhës së huaj
29.04.2022	121.10

1 - 1 nga 1 rezultate
Faqe 1 nga 1

 Eksporto csv

 Eksporto xls

 Eksporto pdf

1 - 1 nga 1 rezultate
Faqe 1 nga 1

Data	Lekë për njësi të monedhës së huaj	
	Mesatarja e çmimit në blerje (Bid)	Mesatarja e çmimit në shitje (Ask)
29.04.2022	120.76	121.43

1 - 1 nga 1 rezultate
Faqe 1 nga 1

 Eksporto csv